



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), Neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës për punën e Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar ndaj lëndës së formuar pas denoncimit të parashtruar, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në vazhdimin e seancës së 60-të, të mbajtur më 31.01.2022, miratoi si në vijim.

#### VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-1157/1 e datës 15.03.2021, me të cilën shpreh pakënaqësinë me zbatimin e procedurës së denacionalizimit pranë Komisionit për vendosjen ndaj kërkesës për denacionalizim për territorin e komunës ----- dhe -----, **REFUZOHET.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë, ndaj lëndës së theksuar ka vepruar organi kompetent, në rastin konkret Gjykata Administrative dhe Gjykata Administrative e Lartë e RMV-së.

Lënda me numër 12-1157/1 të datës 15.03.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

#### Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur me datën 04.06.2021, është dorëzuar denoncim me të cilën shpreh pakënaqësi për zbatimin e procedurës së denacionalizimit pranë Komisionit për vendosjen ndaj kërkesës për denacionalizim për territorin e komunës ----- dhe ----- dhe është formuar lënda 12-1157/1 nga 15.03.2021.

Në denoncim, parashtruesit kërkojnë që të iniciohet procedurë kundër Komisionit për vendosjen ndaj kërkesës për denacionalizim për territorin e komunës ----- dhe ----- me selinë në----- ----- për arsye të dyshimeve themelore se komisioni i përmendur ose ndonjë anëtar i saj ka bërë keqpërdorim të detyrës, më tutje ka bërë shkelje të nenit 63 nga LPKKI, sepse për më shumë se 19 vjet kanë shmangur vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në rastin e ----. Nr.----- Më tej, parashtruesit deklarojnë në disa raste se Gjykata Administrative e RMV-së dhe Gjykata e Lartë Administrative kanë anuluar vendimet e Komisionit për vendosjen e kërkesës për denacionalizim të territorit të komunës ----- dhe -----.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit ka konstatuar se nuk ka elemente për veprim kompetent në rastin në fjalë. Ndaj rastit të përmendur veproi organi tjetër kompetent, Gjykata Administrative e RMV-së dhe Gjykata e Lartë Administrative.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: S.M

Miratoi: Mr. SH.S anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHETËTOR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Nënkryetar  
Goran Trpenoski

